




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike 2005 - 2007



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike 2005 - 2007



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)

Data e botimit: Dhjetor 2009

© : Enti i Statistikës së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qasenë përmes veb-faqes së ESK-së
në internet: www.ks-gov.net/esk

Parathënie

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) ka përpiluar të dhënat provizionale të Bruto Produktit Vendor (BPV) për vitet 2005-2007 sipas aktiviteteve. Po ashtu ka vlerësuar edhe normën e rritjes ekonomike sipas aktiviteteve me çmime aktuale dhe konstante. Llogaritë kosovare janë përpiluar në bazë të rekomandimeve të Sistemit Evropian të Llogarive të vitit 1995 (ESA'95). Për të bërë këto vlerësime janë përdorë tabelat ofruese përdoruese.

Këto janë të dhëna shumë të kërkuara, veçmas norma e rritjes së BPV, e cila përdoret për planifikim ekonomik të Qeverisë, donatorëve për të vlerësuar programet mbështetëse për sektorë të ndryshëm të ekonomisë, si dhe në zhvillimin e shtetit në përgjithësi. Rezultatet e llogarive kombëtare po ashtu përdoren edhe nga investitorët e jashtëm dhe të brendshëm për të vlerësuar situatën ekonomike të shtetit dhe mundësitë për investime të reja.

ESK do të vazhdojë zhvillimin e Llogarive Kombëtare në pajtim me rekomandimet ndërkombëtare dhe do të publikojë të dhëna kualitative dhe me kohë.

Ky publikim është përgatitur nga Divizioni i Llogarive kombëtare: Ilir T. Berisha - Drejtor i statistikave ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Xhevrie Fetahu, Shqiponjë Bekteshi, Ylli Shala, Ilir Mazrekaj, Ibrahim Rrustemi dhe Emine Bajrami, në bashkëpunim me Clementina Ivan-Ungureanu, eksperte kyçe e Llogarive Kombëtare nga (Projekti i Unionit Evropian "Përkrahje e mëtutjeshme ESK").

Falënderojmë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, Ministrinë e Administratës Publike (sektori i OJQ-ve), ndërmarrjet, zyret rajonale dhe agjensionet tjera për bashkëpunim.

Komentet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura.

Dhjetor, 2009

Kryeshafi Ekzekutiv i ESK-së,
Avni Kastrati

Përmbajtja

	Faqe
I. Hyrje	5
1. Rezidenca	5
2. Vlerësimi	6
3. Outputi	6
4. Konsumi i ndërmjetëm	7
5. Vlera e shtuar.....	7
II. Bruto Produkti Vendor (BPV).....	8
III. Kategoritë e përdorimit final: konsumi dhe formimi i kapitalit.....	9
1. Konsumi final i ekonomisë familjare:.....	9
2. Konsumi final nga institucionet qeveritare dhe jo profitabile:	9
3. Formimi i bruto kapitalit.....	9
IV. Tabelat ofruese - përdoruese.....	10
- Burimet e të dhënave:.....	11
V. Elaborimi i prodhimit dhe gjenerimit të llogarive të te hyrave ne sektorin institucional.....	12
Tabela 1: Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale 2005-2007	13
Tabela 2: Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve 2005-2007.....	13
Tabela 3: Prodhimi me çmime aktuale 2005.....	14
Tabela 4: Konsumi i ndërmjetëm me çmime aktuale 2005.....	15
Tabela 5: Prodhimi me çmime aktuale 2006.....	16
Tabela 6: Konsumi i ndërmjetëm me çmime aktuale 2006.....	17
Tabela 7: Prodhimi me çmime konstante 2006.....	18
Tabela 8: Konsumi i ndërmjetëm me çmime konstante 2006.....	19
Tabela 9: Prodhimi me çmime aktuale 2007.....	20
Tabela 10: Konsumi i ndërmjetëm me çmime aktuale 2007	21
Tabela 11: Llogaria e prodhimit – Përdorimet 2005.....	22
Tabela 12: Gjenerimi i llogarisë së të ardhurave – Përdorimet 2005.....	23
Tabela 13: Llogaria e prodhimit – Burimet 2005.....	24
Tabela 14: Gjenerimi i llogarisë së të ardhurave – Burimet 2005.....	25
Tabela 15: Llogaria e prodhimit – Përdorimet 2006.....	26
Tabela 16: Gjenerimi i llogarisë së të ardhurave – Përdorimet 2006.....	27
Tabela 17: Llogaria e prodhimit – Burimet 2006.....	28
Tabela 18: Gjenerimi i llogarisë së të ardhurave – Burimet 2006.....	29
Tabela 19: Llogaria e prodhimit – Përdorimet 2007.....	30
Tabela 20: Gjenerimi i llogarisë së të ardhurave – Përdorimet 2007.....	31
Tabela 21: Llogaria e prodhimit – Burimet 2007.....	32
Tabela 22: Gjenerimi i llogarisë së të ardhurave – Burimet 2007.....	33

I. Hyrje

Llogaritë kombëtare paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe tërësore për të gjitha transaksionet që kanë ndodhur brenda një periudhe të caktuar, dhe në këtë mënyrë ato paraqesin një pamje të përgjithshme të ekonomisë kosovare. Ato ofrojnë një përshkrim sistematik, të qëndrueshëm statistikor të ekonomisë në përgjithësi dhe të raportit reciprok ndërmjet sektorëve të ndryshëm ekonomik dhe ekonomisë në përgjithësi si dhe pjesës jo-rezidente. Në llogaritë kombëtare, shoqëria është e ndarë në sektorë dhe në llogari të aktiviteteve, të cilat formojnë një pjesë të sistemit të përgjithshëm të llogarive kombëtare. Vetë llogaritë në një mënyrë më të përmbledhur paraqesin një masë të madhe të informacioneve të hollësishme, të organizuara në bazë të parimeve dhe perceptimeve ekonomike lidhur me funksionimin e ekonomisë.

Llogaritë kombëtare kryejnë shumë funksione:

Së pari, ato shërbejnë si mjet për të monitoruar zhvillimin e ekonomisë dhe të politikës ekonomike nëpërmjet vrojtimit dhe analizave të bashkëveprimeve ekonomike që ndodhin ndërmjet sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Më saktësisht, të dhënat e përgjithshme të llogarive të ndryshme kombëtare, për shembull rritja e BPV-së, shfrytëzohen nga Qeveria për planifikim ekonomik.

Të dhënat dhe korniza themelore mund të shfrytëzohen në modelet ekonometrike, në çështjet buxhetore kombëtare, planifikimin makroekonomik, parashikimet dhe analizat teorike.

Rezultatet e llogarive kombëtare po ashtu përdoren edhe nga investitorët e jashtëm dhe të brendshëm për të vlerësuar situatën ekonomike të shtetit dhe mundësitë për investime të reja.

ESK do të vazhdojë zhvillimin e llogarive kombëtare në pajtim me rekomandimet ndërkombëtare dhe do të publikojë të dhëna kualitative dhe me kohë.

Llogaritë kosovare janë përpiluar në bazë të rekomandimeve të Sistemit Evropian të Llogarive të vitit 1995 (ESA'95). Për të bërë këto vlerësime me çmime aktuale janë përdorë tabelat ofruese përdoruese.

1. Rezidenca

Në llogaritë kombëtare duhet të regjistrohen të gjitha transaksionet në të cilat janë të përfshirë rezidentët. Prandaj, është e rëndësishme që të kemi një definicion të qartë të rezidencës. Definicioni i rezidencës është identik për tërë llogaritjet makroekonomike, si për statistikën monetare dhe financiare ashtu edhe për llogaritë qeveritare, llogaritë kombëtare dhe bilancin e pagesave.

Praktikisht, personat konsiderohen si rezidentë të një shteti nëse ata jetojnë për së paku një vit në atë shtet. Përfshirë në këtë rregull bëjnë personeli i ambasadave (me përjashtim të personelit vendor), pacientët që trajtohen jashtë shtetit dhe studentët që jetojnë jashtë shtetit, edhe atëherë kur qëndrimi i tyre ka tejkaluar një vit.

ESK-ja ka ndjekur këto udhëzime gjatë përpilimit të llogarive kombëtare për vitin 2005 - 2007. Megjithatë, Kosova nxjerrë në pah disa veçori të jashtëzakonshme për faktin se Kombet e Bashkuara kanë luajtur një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm. UNMIK-u, një organ i Kombeve të Bashkuara, ka marrë shumë nga funksionet 'normale' të qeverisë. Në këtë kuptim, konsiderohet si rezident i Kosovës edhe pse ESA në mënyrë të qartë përcakton se organizatat ndërkombëtare duhet të konsiderohen si jo rezidente.

2. Vlerësimi

Outputi dhe vlera e shtuar duhet të vlerësohen në baza akruale kur produkti del nga procesi i prodhimit. Outputi dhe vlera e shtuar mund të maten në mënyra të ndryshme, varësisht nga cilat tatime dhe subvencione në prodhim dhe në importe (që zakonisht referohen si tatime indirekte). ESA '95 rekomandon vlerësimin me çmimet bazë. Çmimi bazë është vlera e një malli apo një shërbimi të pranuar nga prodhuesi para aplikimit të ndonjë tatimi apo subvencioni përveç atyre të tatuara apo të pranuar para fillimit të procesit të prodhimit. Tatimet e tilla referohen si "tatimet tjera në prodhim" në ESA '95, dhe kryesisht përbëhen nga tatimet mbi shfrytëzimin e tokës dhe objekteve nga ndërmarrjet dhe lejeve të punës. Transferi i qeverisë një institucioni me qëllim të pakësimit të ndotjes, pavarësisht nga sasia e prodhimit, do të jetë një shembull i subvencionit të pranuar para fillimit të procesit të prodhimit.

Çmimi prodhues është kur çmimit bazë i shtohen tatimet dhe subvencionet tjera në prodhim dhe importe (përveç tatimeve mbi vlerën e shtuar); këto tatime referohen si tatime dhe subvencione në produkte. Shembujt më të rëndësishëm të këtyre tatimeve janë tatimet në shitje, akciza dhe tatimet e importit. Subvencionet marrin shumë forma të ndryshme, nga të cilat më të zakonshmet janë subvencionet në eksport dhe import.

3. Outputi

Outputi vlerësohet brenda një periudhe të caktuar kohore si vlerë e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara nga ndërmarrjet rezidente. Outputi mund t'iu ofrohet njërive tjera ose mund të shfrytëzohet për konsum vetanak apo për formimin e bruto kapitalit fiks vetanak.

Outputi përbëhet nga dy kategori: konsum final dhe puna në progres. Vlera e shumicës së artikujve regjistrohet vetëm atëherë kur procesi i prodhimit të ketë përfunduar. Megjithatë, prodhimi i produkteve të caktuara mund të vazhdojë edhe pas përfundimit të periudhës llogaritëse. Në këtë rast puna në progres vlerësohet dhe regjistrohet. Puna në progres është posaçërisht relevante në ndërtimtari dhe bujqësi.

Outputi mund të klasifikohet sipas tri llojeve:

- Output për treg i mallrave dhe shërbimeve është ai output, i shitur me çmime të cilat ekonomikisht janë të rëndësishme për treg ose gjenden në treg. Sipas konventes dhe rregullave të llogarive kombëtare, të gjitha mallrat parashihen të shiten ose gjenden në treg.

- Output për konsum vetanak përbehet nga mallrat dhe shërbimet të cilat konsumohen brenda të njëjtës ndërmarrje, në të cilën janë prodhuar. Meqë korporatat nuk kanë konsum final, outputi për konsum vetanak prodhohet vetëm nga ndërmarrjet e pa inkorporuara: psh produktet bujqësore të prodhuara dhe të konsumuara nga anëtarët e të njëjtës ekonomi shtëpiake. Mallrat dhe shërbimet e përdorura për formimin e bruto kapitalit fiks vetanak mund të prodhohen nga çdo lloj ndërmarrjeje. Kjo përfshinë makinerinë ose punët në ndërtimtari për nevoja vetanake, të ndërtesave ose shtimin e ndonjë pjese të ndërtesës të kryer nga anëtarët e ekonomisë shtëpiake.

Outputet tjera jo për treg: përbëhen nga mallrat dhe shërbimet individuale apo kolektive të kryera nga Qeveria e përgjithshme ose institucionet jo profitabile të cilat iu shërbejnë ekonomive shtëpiake, të ofruara pa pagesë apo me çmim që nuk është ekonomikisht domethënës për njësitë institucionale tjera ose bashkësinë si tërësi, për shembull shërbimet e arsimit të ofruara nga qeveria.

4. Konsumi i ndërmjetëm

Konsumi i ndërmjetëm është vlera e përgjithshme e mjeteve të përdorura, konsumuara apo të transformuara gjatë procesit të prodhimit. Konsumi i ndërmjetëm përfshinë mallrat dhe shërbimet e prodhuara vetëm nga njësia tjetër ekonomike (prodhimi vetanak nuk përshihet). Ngjashëm me outputin, ai vlerësohet brenda një periudhe të caktuar kohore. Siç është përmendur më lartë, konsumi i ndërmjetëm vlerësohet sipas çmimeve të blerjes, i përcaktuar si çmim prodhues, plus pagesat për transport dhe marzha e tregtisë me shumicë dhe pakicë.

5. Vlera e shtuar

Vlera e shtuar është një koncept thelbësor ekonomik i prodhimit që i referohet vlerës së prodhuar nga njësia e angazhuar në veprimtari prodhuese. Bruto vlera e shtuar definohet si output i përgjithshëm (i vlerësuar sipas çmimeve bazë), minus konsumi i ndërmjetëm, dhe neto vlera e shtuar sikurse bruto vlera e shtuar minus konsumi i kapitalit fiks. Neto vlera e shtuar pasqyron më mirë nivelin e veprimtarisë prodhuese; por për shkak të vështirësisë së matjes së saktë të konsumit të kapitalit fiks, bruto vlera e shtuar si koncept përdoret më shpesh se sa koncepti neto vlera e shtuar.

Vlera e shtuar llogaritet veçmas për secilën veprimtari rezidente në ekonomi. Ajo ofron një vlerësim të rëndësishëm të aktiviteteve prodhuese në detaje.

II. Bruto Produkti Vendor (BPV)

Treguesi më i rëndësishëm ekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare është Bruto Produkti Vendor (BPV), i cili paraqet performancën e ekonomisë së një shteti në një periudhë të caktuar.

BPV-ja me çmimet bazë është shuma e vlerës së shtuar e të gjitha njësive rezidente prodhuese. Në këtë mënyrë, ai është një vlerësim i përgjithshëm i prodhimit që ndodhë brenda një periudhe të caktuar kohore. Ngjashëm me outputin, vlerësimi i BPV-së mund të ndryshojë varësisht se cilat tatime në prodhim dhe importe janë përfshirë. Kur tatimet në produkte i shtohen shumës totale të vlerës së shtuar, atëherë BPV-ja vlerësohet sipas çmimeve të tregut. Duke lënë anash tatimin mbi vlerën e shtuar në këtë vlerësim, fitohet BPV-ja sipas çmimeve të prodhuese.

Vlen të ceket se BPV-ja bën vlerësimin e prodhimit nga njësitë rezidente, pavarësisht nga lokacioni i veprimtarisë prodhuese.

Bruto produkti vendor sipas qasjes së prodhimit, është e barabartë me shumën e gjithsej të bruto vlerës së shtuar për të gjitha veprimtaritë ekonomike.

Pasi që ana furnizuese e të gjitha komponentëve mbi vlerën e shtuar për të gjitha mallrat dhe shërbimet duhet të jetë e barabartë me shpenzimet e përgjithshme në produktet e njëjta, atëherë duhet të merren parasysh karakteristikat e mëposhtme:

BPV me çmimet e tregut = konsumi final + formimi i bruto kapitalit fiks + ndryshimet në inventarë + eksporti (i mallrave dhe shërbimeve) - importi (i mallrave dhe shërbimeve). Më fjalë tjera, BPV sipas prodhimit është i barabartë me BPV sipas shpenzimeve.

Qasja e prodhimit

BPV = BVSH+TP-SP

Prej nga:

BPV = Bruto produkti vendor (me çmimet e tregut)

BVSH = Bruto vlera e shtuar (me çmimet bazë)

TP = Tatimet ne produkte

SP = Subvencionet në produkte

III. Kategoritë e përdorimit final: konsumi dhe formimi i kapitalit

Në llogaritë kombëtare regjistrohet konsumi final i ekonomive shtëpiake, i qeverisë dhe institucioneve jo profitabile. Ndërmarrjet nuk konsumojnë në këtë kuptim; siç është përmendur më lartë, produktet e shfrytëzuara gjatë procesit të prodhimit konsiderohen si konsum i ndërmjetëm , e jo konsum final.

1. Konsumi final i ekonomisë familjare:

Ky transaksion është regjistruar sipas çmimeve blerëse dhe përbëhet nga shpenzimet e ekonomisë familjare për të gjitha mallrat dhe shërbimet, me përjashtim të shpenzimeve për banim, të cilat konsiderohen si formim i bruto kapitalit fiks të pronarit. (Megjithatë, qiratë e objekteve dhe banesave klasifikohen si konsum final i shpenzuar nga ekonomia familjare).

2. Konsumi final nga institucionet qeveritare dhe jo profitabile:

Këto transaksione trajtohen në të njëjtën mënyrë në ESA '95. Shpenzimet e bëra nga dy sektorët e fundit mund të ndahen në dy kategori: individuale dhe kolektive. E para përbën shpenzimet e bëra për përfitime individuale, psh. shërbimet mjekësore. Shpenzimet kolektive kanë karakter publik, për shembull shpenzimet qeveritare në mbrojtjen dhe sigurinë publike do të përfshiheshin në këtë kategori.

3. Formimi i bruto kapitalit

Kjo tërësi paraqitet në llogaritë kapitale të llogarive kombëtare dhe në raportin mbi veprimtaritë qeveritare. Është njëra nga dy transaksionet kryesore në asetet kapitale. Siç nënkuptohet nga emri, në formimin e bruto kapitalit fiks paraqiten të gjitha marrjet dhe posedimi i aseteve fikse, që do të thotë se të gjitha asetet e prodhuara, janë të natyrës jo financiare dhe janë të transferueshme ndërmjet njësive prodhuese. Asetet kapitale mund të jenë të prekshme – psh. ndërtesat, objektet, makineria – ose jo të prekshme – psh. softuerët kompjuterik. Ngjashëm me konsumin, ky transaksion vlerësohet sipas çmimeve blerëse.

IV. Tabelat ofruese - përdoruese

Tabelat ofruese përdoruese janë krijuar për të nxjerrë vlera më të sigurta për BPV se sa ato të fituara nga llogaritja e BPV me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve veç e veç. Në tabelat ofruese përdoruese, shifrat nga burimet e ndryshme paraqiten në mënyrë sistematike dhe të organizuar, duke i lejuar përpiluesit që të eliminojnë mospërputhjet dhe të largojë numrat nga burimet e të dhënave jo të sigurta dhe t'i zëvendësojë ato me numra nga burimet më të sakta. Gjithashtu ato i japin përpiluesit një kornizë për të identifikuar dhe plotësuar mungesën e të dhënave.

Tabela ofruese është një matricë, e cila përmban:

- a) Prodhimin me çmimet bazë në matricë (aktivitetet x produktet);
- b) Importet c.i.f (në përputhje me vlerësimin e çmimit bazë); dhe
- c) Tatimet në produkte.

Këto tri transaksione paraqiten në tri kolona të veçanta. Zakonisht, kjo tabelë gjithashtu përmban edhe dy kolona të përshtatjeve: a) marzha tregtare dhe e transportit; dhe b) përshtatjet c.i.f/ f.o.b. Vlerësimi i outputit dhe importeve duhet të bëhet me çmimet bazë, që nënkupton se as marzha tregtare dhe e transportit, por as tatimet në produkte nuk janë përfshirë ende.

Çmimet e importit nga Doganat vlerësohen me c.i.f. (vlerësimi i rekomanduar për tabelën ofruese përdoruese).

Tabela përdoruese gjithashtu është një matricë, dhe përshinë:

- a) konsumin e ndërmjetëm në matricë (aktivitetet x produktet),
- b) konsumin final,
- c) formimin e bruto kapitalit dhe
- d) eksportin.

Këto transaksione vlerësohen me çmimet blerëse, që do të thotë se vlerësimi përfshinë tatimin në prodhim dhe importe, si dhe marzhën tregtare dhe transportit për çdo grup individual të shifrave.

Në tabelat ofruese- përdoruese, të tri transaksionet në anën ofruese balancohen me katër transaksione në anën përdoruese. Kjo bëhet në një nivel detal të prodhimit. Për shembull, vlera e përgjithshme e pjesëve rezervë në anën furnizuese – dmth. pjesët rezervë të prodhuara brenda vendit dhe të importuara – balancohen me vlerën e përgjithshme në anën përdoruese të të njëjtit mall, dmth. konsumi nga njësitë prodhuese (konsumi i ndërmjetëm), konsumi nga ekonomitë familjare (konsumi final), ndryshimet në inventarë dhe konsumi nga jorezidentët (eksportet).

Pasi që vlerësimi i transaksioneve në të dy tabelat është i ndryshëm, krahasimi i të dhënave sipas produkteve në tabelat ofruese dhe përdoruese nuk është kuptimplotë pa përshtatje të mëtejme. Sipas marrëveshjes, këto përshtatje bëhen në tabelat ofruese në formë të kolonave të quajtura marzhat e tregtisë dhe transportit dhe përshtatjet e c.i.f. / f.o.b. Marrëveshja gjithashtu dikton se përshtatjet bëhen në atë mënyrë që vlera e përgjithshme e të gjitha produkteve në tabelat ofruese dhe ato përdoruese të jetë sipas çmimit blerës. Kjo bëhet me qëllim që vlera e përgjithshme e çdo kategorie të produktit të jetë në përputhje në të dy tabelat.

- **Burimet e të dhënave:**

a) Burimet statistikore të të dhënave:

- Rezultatet e anketave të kryera dhe publikuara nga ESK, si: anketa strukturore e ndërmarrjeve 2005-2006, anketa e buxhetit të ekonomive shtëpiake(ABESH), anketa e fuqisë punëtore (AFP), anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore (AESHB) dhe publikimet e ESK;
- Të dhënat e tregtisë së jashtme : importi dhe eksporti i mallrave;
- Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), organizuar rregullisht nga ESK;

b) Burimet administrative:

- Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF), sa i përket të dhënave te buxhetit dhe të thesarit;
- Banka Qendrore e Kosovës (BQK), sa i përket të dhënave të Bilancit të pagesave (BoP);
- OSBE sa i përket të dhënave të partive politike;
- Ministria e Shërbimeve Publike sa i përket të dhënave të Organizatave jo qeveritare (OJQ).

V. Elaborimi i prodhimit dhe gjenerimit te llogarive të te hyrave ne sektorin institucional

ESK ka zhvilluar Sistemin e Thjeshtësuar të Ndërmjetëm dhe ka paraqitur në mënyrë metodologjike rrugën në të cilën informatat nga të dhënat statistikore dhe administrative përdoren për të përpiluar transaksionet e llogarisë së prodhimit dhe llogarisë së gjenerimit të të ardhurave

Sistemin e Thjeshtësuar të Ndërmjetëm është zhvilluar duke pasqyruar tri kritere : shkallën e mbulimit të njësive (duhet të sigurohen të dhëna për të gjitha njësitë, për çdo sektor), shkalla e homogjenitetit (krijimi i një kornize identike për këto njësi), dhe pajtueshmëria (kapaciteti për të integruar një numër të madh të indikatorëve për qëllime të llogarive kombëtare).

Sistemin e Thjeshtësuar të Ndërmjetëm është përpunuar për secilin sektor institucional: korporatat jo-financiare, korporatat financiare, qeverinë e përgjithshme , institucionet jo-profitabile, që u shërbejnë ekonomive familjare dhe pjesës tjetër të botës, në bazë të burimeve të të dhënave të disponueshme.

- Sistemin e Thjeshtësuar të Ndërmjetëm për Korporatat jo financiare i referohet sistemit përmes të cilit treguesit nga anketa e biznesit përdoren për qëllime të llogarive kombëtare.
- Për sektorin institucional korporatat financiare janë përdorur pasqyrat financiare të njësive të cilat e përbejnë këtë sektor (Banka Qendrore, bankat e tjera komerciale, ndërmjetësuesit tjerë financiar, korporatat e sigurimit dhe njësitë tjera ndihmëse financiare). Sistemin e Thjeshtësuar të Ndërmjetëm për këtë sektor institucional paraqet mënyrën në të cilën këto të dhëna nga këto burime përdoren për vlerësimin e treguesve të llogarive kombëtare
- Në mënyrë që të themelohet Sistemin e Thjeshtësuar të Ndërmjetëm për Sektorin Qeveritar është realizuar një analizë e thellë e të hyrave dhe shpenzimeve. Secili artikull është klasifikuar në treguesit e llogarive kombëtare në bazë të metodologjisë ESA 95.
- Pasqyrat financiare të organizatave jo qeveritare (OJQ) dhe partive politike të cilat përfaqësojnë sektorin institucional të Institucioneve jo-profitabile që iu shërbejnë ekonomive shtëpiake (NPISH), janë analizuar, dhe treguesit e nevojshëm për të vlerësuar llogarinë e prodhimit dhe llogarinë e gjenerimit të të ardhurave janë identifikuar dhe zhvendosur në kuadër të sistemit të thjeshtuar.
- Bilanci i Pagesave i përpunuar nga Banka Qendrore e Kosovës është përdorë për elaborimin e Sistemin e Thjeshtësuar të Ndërmjetëm për sektorin Pjesa tjetër e botës. Të dhënat në lidhje me importet dhe eksportet e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme janë klasifikuar në treguesit e llogarive kombëtare.

Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteve ekonomike 2005 - 2007

Tabela 1: Bruto produkti vendor sipas aktiviteve ekonomike me çmime aktuale 2005-2007

Nr.	Aktivitetet ekonomike	Pjesëmarrja e BPV me çmimet e prodhimit			Bruto Vlera e Shtuar			Konsumi i ndërmjetëm			Outputi		
		2005	2006	2007	2005	2006	2007	2005	2006	2007	2005	2006	2007
1	Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi	11,3	11,7	12,0	346,9	372,4	413,6	508,3	547,5	571,9	855,1	919,9	985,5
2	Industria nxjerrëse	0,6	0,6	0,7	19,2	20,4	25,2	40,4	37,7	49,5	59,6	58,1	74,7
3	Industria përpunuese, furnizimi me energji elektrike, me gaz dhe me ujë	13,1	12,9	11,2	401,9	411,3	384,8	586,0	579,9	744,3	987,9	991,2	1.129,1
4	Ndërtimtaria	8,4	8,9	10,0	257,8	284,2	342,4	347,4	382,9	512,5	605,2	667,1	854,9
5	Tregetia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe i artikujve për përdorim personal dhe shtëpiak	10,2	10,2	9,4	313,7	326,0	323,6	73,6	76,5	99,4	387,3	402,5	423,0
6	Hotelet dhe restorantet	0,7	0,8	0,7	22,7	24,5	25,6	17,9	19,3	20,2	40,7	43,8	45,9
7	Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	4,2	4,6	3,6	127,8	145,5	122,7	159,6	175,2	159,0	287,4	320,7	281,7
8	Ndërmjetesimi financiar	2,5	3,0	4,4	77,6	96,1	149,7	36,0	38,9	39,8	113,6	135,0	189,5
9	Afazarimi me pasuri të patundshme, dhënia me qira dhe shërbime të afazarizmit	12,8	12,8	12,4	392,5	408,7	425,2	80,4	86,1	92,5	472,9	494,8	517,7
10	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi social i detyrueshëm	16,8	15,0	13,2	514,0	480,1	454,3	54,7	61,7	55,1	568,7	541,8	509,4
11	Arsimi	2,8	2,8	2,7	84,6	89,2	91,8	40,7	42,9	48,1	125,2	132,1	139,9
12	Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	1,7	1,3	1,1	52,8	41,9	36,9	25,7	20,4	28,4	78,5	62,3	65,3
13	Vepimtari të tjera shoqërore sociale, të shërbimeve dhe personale	1,4	1,3	1,6	41,8	41,9	53,6	38,7	37,4	48,0	80,5	79,3	101,6
14	Gjithsej aktivitetet (1-13)	100	100	100	2.653,2	2.742,2	2.845,8	2.009,5	2.106,5	2.468,8	4.662,7	4.848,7	5.318,1
15	Plus: Tatimet në produkte	13,5	14,1	17,1	415,2	449,5	587,8						
16	BPV (14 + 15)				3.068,4	3.191,7	3.433,6						

Tabela 2: Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve 2005-2007

	(në milion Euro)		
	2005	2006	2007
BPV me qasjen e shpenzimeve	3.068,4	3.191,7	3.433,6
Shpenzimet e konsumit final te ekonomive shtëpiake	2.705,8	2.864,7	3.248,4
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	705,2	670,8	641,6
Qeveria e Kosovës	329,2	340,8	327,3
Donatorët (pagat)	376,0	330,0	314,4
Të punësuar te huaj	258,0	213,0	196,9
Të punësuar vendor	118,0	117,0	117,4
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	23,7	24,8	23,1
Formimi i bruto kapitalit	722,3	798,3	892,6
Formimi i bruto kapitalit fiks	592,8	657,1	744,3
Ndryshimet në inventar	129,4	141,2	148,3
<i>Eksporti neto</i>	-1.088,6	-1.166,9	-1.372,0
Exporti	214,7	285,6	356,8
Importi	1.303,3	1.452,5	1.728,8

Tabela 3: Prodhimi me çmime aktuale 2005

(në 000 Euro)

CPA		Prodhimi	Importi i mallrave dhe shërbimeve	Gjithsej oferta me çmime bazë	Marzha tregtare dhe transporti	Tatimi ne produkte	Ndihmat ne produkte	Gjithsej oferta me çmime blerëse
A	Produktet e bujqësisë, gjuetisë, pylltarisë dhe shërbimet lidhur me to	840.392	47.438	887.829	46.529	11.813	0	946.172
B	Produktet e peshkimit dhe shërbimet e peshkimit	14.752	171	14.922	35	34	0	14.991
C	Thengjilli dhe ligniti; nafta e paperpunuar; gasi natyral	59.585	5.124	64.709	6.883	3.108	0	74.700
D	Prodhimi industrial	624.678	1.088.832	1.713.510	331.105	414.879	0	2.459.495
E	Rryma elektrike, gazi, uji i ngrohtë dhe avulli	363.210	16.723	379.933	0	9.035	-60.072	328.895
F	Punet në ndërtimtari	605.175	8.703	613.878	0	15.470	0	629.348
G	Sherbimet e tregtisë me shumicë dhe pakicë; shërbimet e riparimit te motorave, motoçikletave dhe paisjeve shtëpiake e personale	387.337	0	387.337	-384.552	287	0	3.071
H	Sherbimet e hotelerisë dhe restoranteve	40.692	56.356	97.048	0	4.337	0	101.385
I	Sherbimet e transportit, ruajtjes dhe komunikimit	287.441	60.095	347.535	0	9.330	0	356.865
J	Sherbimet e ndërmjetësimit financiar	113.603	3.209	116.812	0	944	0	117.756
K	Sherbimet e patundshmërisë, qiradhënies dhe bizneseve	472.858	13.802	486.660	0	28	0	486.688
L	Sherbimet e administrates publike dhe mbrojtjes, shërbimet e obligueshme te sigurisë shoqerore	568.703	2.888	571.591	0	0	0	571.591
M	Sherbimet e arsimit	125.240	0	125.240	0	1.525	0	126.764
N	Sherbimet shëndetsore dhe sociale	78.548	0	78.548	0	806	0	79.354
O	Sherbimet tjera te komunitetit, shoqerore dhe personale	80.465	0	80.465	0	3.657	0	84.122
P	Ekonomitë shtëpiake private me persona të punësuar	0	0	0	0	0	0	0
	Gjithsej	4.662.678	1.303.340	5.966.018	0	475.252	-60.072	6.381.197

Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteve ekonomike 2005 - 2007

Tabela 4: Konsumi i ndërmjetëm me çmime aktuale 2005

(në 000 Euro)

		Përdoruesit përfundimtar											
	Konsumi i ndërmjetëm	Shpenzimet e konsumit përfundimtar te ekonomive shtëpiake	Shpenzimet e konsumit përfundimtar të IJPSHESH	Shpenzimet e konsumit përfundimtar të Qeverisë	Gjithsej shpenzimet e konsumit përfundimtar	Formimi i bruto kapitalit fiks	Ndryshimet në inventar	Formimi i bruto kapitalit fiks dhe ndryshimet në inventar	Gjithsej përdoruesit përfundimtar vendor	Eksporti	Gjithsej përdoruesit përfundimtar	Gjithsej përdoruesit	
CPA													
A	Produktet e bujqësisë, gjuetisë, pylltarisë dhe shërbimet lidhur me to	463.374	472.317	0	0	472.317	0	8.166	8.166	480.484	2.315	482.798	946.172
B	Produktet e peshkimit dhe shërbimet e peshkimit	7.495	7.495	0	0	7.495	0	0	0	7.495	0	7.495	14.991
C	Thengjilli dhe ligniti; nafta e papërpunuar; gasi natyral	53.588	16.338	0	0	16.338	0	3.721	3.721	20.059	1.052	21.111	74.700
D	Prodhimi industrial	753.661	1.365.660	0	0	1.365.660	109.357	117.559	226.916	1.592.577	113.256	1.705.833	2.459.494
E	Rryma elektrike, gazi, uji i ngrohtë dhe avulli	242.214	85.436	0	0	85.436	0	0	0	85.436	1.246	86.682	328.895
F	Punët në ndërtimtarë	62.935	83.101	0	0	83.101	483.312	0	483.312	566.413	0	566.413	629.348
G	Shërbimet e tregtisë me shumicë dhe pakicë; shërbimet e riparimit të motorave, motoçikletave dhe pajisjeve shtëpiake e personale	307	2.764	0	0	2.764	0	0	0	2.764	0	2.764	3.071
H	Shërbimet e hotelerisë dhe restoranteve	9.450	59.178	0	0	59.178	0	0	0	59.178	32.756	91.935	101.385
I	Shërbimet e transportit, ruajtjes dhe komunikimit	173.391	128.180	0	0	128.180	0	0	0	128.180	55.295	183.475	356.865
J	Shërbimet e ndërmjetësimit financiar	92.711	14.090	3.828	0	17.919	0	0	0	17.919	7.127	25.045	117.756
K	Shërbimet e patundshmërisë, qiradhënies dhe bizneseve	104.671	380.276	269	0	380.545	175	0	175	380.720	1.297	382.017	486.688
L	Shërbimet e administratës publike dhe mbrojtjes, shërbimet e obligueshme të sigurisë shoqërore	7.257	10.486	1.379	552.469	564.334	0	0	0	564.334	0	564.334	571.591
M	Shërbimet e arsimit	9.668	14.682	9.130	93.284	117.096	0	0	0	117.096	0	117.096	126.764
N	Shërbimet shëndetsore dhe sociale	4.380	11.779	5.502	57.693	74.974	0	0	0	74.974	0	74.974	79.354
O	Shërbimet tjera të komunitetit, shoqërore dhe personale	24.354	54.017	3.641	1.754	59.412	0	0	0	59.412	356	59.768	84.122
P	Ekonomitë shtëpiake private me persona të punësuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Gjithsej konsumi i ndërmjetëm/përdorimi përfundimtar	2.009.457	2.705.800	23.750	705.200	3.434.750	592.843	129.447	722.290	4.157.040	214.700	4.371.740	6.381.197

Tabela 5: Prodhimi me çmime aktuale 2006

								(në 000 Euro)
		Prodhimi	Importi i mallrave dhe shërbimeve	Gjithsej oferta me çmime bazë	Marzha tregtare dhe transporti	Tatimi ne produkte	Ndihmat ne produkte	Gjithsej oferta me çmime blerëse
CPA								
A	Produktet e bujqësisë, gjuetisë, pylltarisë dhe shërbimet lidhur me to	903.900	60.094	963.995	47.803	15.286	0	1.027.084
B	Produktet e peshkimit dhe shërbimet e peshkimit	16.005	320	16.325	60	649	0	17.035
C	Thengjilli dhe ligniti; nafta e paperpunuar; gasi natyral	58.093	4.991	63.083	6.224	3.057	0	72.364
D	Prodhimi industrial	662.606	1.215.003	1.877.608	345.525	432.844	0	2.655.977
E	Rryma elektrike, gazi, uji i ngrohtë dhe avulli	328.622	24.548	353.170	0	8.891	-50.049	312.013
F	Punet në ndërtimtari	667.081	5.311	672.393	0	15.959	0	688.352
G	Shërbimet e tregtisë me shumicë dhe pakicë; shërbimet e riparimit të motorave, motoçikletave dhe paisjeve shtëpiake e personale	402.506	0	402.506	-399.613	278	0	3.171
H	Shërbimet e hotelerisë dhe restoranteve	43.843	61.937	105.779	0	4.011	0	109.790
I	Shërbimet e transportit, ruajtjes dhe komunikimit	320.719	57.388	378.106	0	11.545	0	389.652
J	Shërbimet e ndërmjetësimit financiar	134.996	4.884	139.880	0	712	0	140.592
K	Shërbimet e patundshmërisë, qiradhënies dhe bizneseve	494.768	14.391	509.159	0	506	0	509.665
L	Shërbimet e administratës publike dhe mbrojtjes, shërbimet e obligueshme të sigurisë shoqërore	541.774	2.988	544.761	0	0	0	544.761
M	Shërbimet e arsimit	132.089	0	132.089	0	1.863	0	133.952
N	Shërbimet shëndetsore dhe sociale	62.319	0	62.319	0	813	0	63.131
O	Shërbimet tjera të komunitetit, shoqërore dhe personale	79.332	646	79.978	0	3.145	0	83.123
P	Ekonomitë shtëpiake private me persona të punësuar	0	0	0	0	0	0	0
	Gjithsej	4.848.652	1.452.500	6.301.152	0	499.559	-50.049	6.750.663

Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike 2005 - 2007

Tabela 6: Konsumi i ndërmjetëm me çmime aktuale 2006

(në 000 Euro)

		Përdoruesit përfundimtar											
	Konsumi i ndërmjetëm	Shpenzimet e konsumit përfundimtar të ekonomive shtëpiake	Shpenzimet e konsumit përfundimtar të IJPSHESH	Shpenzimet e konsumit përfundimtar të Qeverisë	Gjithsej shpenzimet e konsumit përfundimtar	Formimi i bruto kapitalit fiks	Ndryshimet në inventar	Formimi i bruto kapitalit fiks dhe ndryshimet në inventar	Gjithsej përdoruesit përfundimtar vendor	Eksporti	Gjithsej përdoruesit përfundimtar	Gjithsej përdoruesit	
CPA													
A	Produktet e bujqësisë, gjetisë, pylltarisë dhe shërbimet lidhur me to	520.369	490.083	0	0	490.083	0	11.667	11.667	501.750	4.965	506.715	1.027.084
B	Produktet e peshkimit dhe shërbimet e peshkimit	9.364	7.671	0	0	7.671	0	0	0	7.671	0	7.671	17.035
C	Thengjilli dhe ligniti; nafta e papërpunuar; gasi natyral	49.196	16.877	0	0	16.877	0	4.177	4.177	21.054	2.114	23.168	72.365
D	Prodhimi industrial	781.828	1.470.834	0	0	1.470.834	124.125	125.356	249.481	1.720.315	153.834	1.874.149	2.655.977
E	Rryma elektrike, gazi, uji i ngrohtë dhe avulli	203.625	99.925	0	0	99.925	0	0	0	99.925	8.462	108.387	312.012
F	Punët në ndërtimtarë	68.600	87.000	0	0	87.000	532.752	0	532.752	619.752	0	619.752	688.352
G	Shërbimet e tregtisë me shumicë dhe pakicë; shërbimet e riparimit të motorave, motoçikletave dhe paisjeve shtëpiake e personale	422	2.749	0	0	2.749	0	0	0	2.749	0	2.749	3.171
H	Shërbimet e hotelerisë dhe restoranteve	22.100	54.500	0	0	54.500	0	0	0	54.500	33.190	87.690	109.790
